



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe bankës KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh”.
3. Projektligji “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe të ujitjes, si dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj dhe Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor i Zhvillimit të Politikave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aurora Vasili – Drejtoreshë e Zyrës së Zbatimit të Projekteve tek Operatori i Sistemit të Transmetimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina – Specialiste e medias në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist i Drejtorisë së Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Etleva Alushi – Specialiste në Drejtorinë e Projektit të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës së punës së këtij komisioni kemi disa çështje.

Do ta nisim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas të projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe bankës KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë) nëpërmjet një huaje prej 42 milionë eurosh”.

Relator i komisionit lidhur me këtë projektligj është zoti Arben Pëllumbi. Në komision është prezente zëvendësministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Dorina Çinari.

Do të procedojmë me shpjegimet e zonjës zëvendësministre dhe pastaj me relatorin e komisionit.

Urdhëroni, zonja Zëvendësministre, fjala është për ju!

Dorina Çinari – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Nëpërmjet ligjit nr. 10148, datë 11.03.2010 është miratuar me ligj marrëveshja e financimit për ndërtimin e linjës 400 kilovoltë Tiranë – Prishtinë, një financim i dakordësuar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe qeverisë gjermane nëpërmjet bankës KfW Frankfurt am Main.

Linja e transmetimit ka përfunduar në vitin 2016. Në përfundim të ndërtimit të saj pati tepriçë financiare, pra nga 42 milionë euro, linja u përfundua me rreth 36 milionë euro dhe u ra dakord në parim ndërmjet KfW-së, OST-së, Ministrisë së Financave dhe ministrisë sonë për të ndërtuar edhe nënstacionin e Komanit 400 kilovoltë, i cili optimizon tërësisht funksionimin e rrjeteve në këtë zonë të vendit.

Projektligji i sotëm ka për qëllim vetëm shtyrjen e afatit të disbursimit të kësaj huaje nga dhjetori i vitit 2017 në dhjetorin e vitit 2018. Nënstacioni është në ndërtim dhe pritet të përfundojë në shtator të vitit 2018 dhe qëllimi është vetëm që të mundësohen veprimet e nevojshme financiare deri në dhjetor të vitit 2018.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Çinari!

Fjalën e ka relatori i komisionit, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre, për shpjegimet që dhatë!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW-së Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në pikën 1 të nenit 81 të Kushtetutës, si dhe neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 43 të vitit 2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji shqyrtohet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit dhe ne, si Komision Ekonomie, jemi komision përgjegjës.

Sikurse e tha edhe zëvendësministrja, projektligji ka për qëllim shtyrjen e datës së disbursimeve nga 30 dhjetori i vitit 2017, në 30 dhjetorin e vitit 2018 të afatit të financimit të projektit. Kjo shtyrje afati nevojitet për të realizuar kompletimin e projektit, që ka për objekt zgjerimin e nënstacionit 400 kilovoltë të hidrocentralit të Komanit. Ky zgjerim synon lidhjen e këtij hidrocentrali me rrjetin 400 kilovoltë “Tirana 2 – Kosova B”, me anën e një autotransformatori, sipas specifikimeve që përcaktohen në kontratën ndërmjet palëve. Zgjerimi i nënstacionit të hidrocentralit të Komanit do të sjellë reduktimin e humbjeve të fuqisë në rrjet dhe përmirësimin e funksionit të sistemit të transmetimit ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja bazë për financimin e këtij projekti është ratifikuar me ligjin nr. 10143, datë 11.03.2010 dhe parashikonte përfundimin e disbursimit të huas në datën 30 qershor të vitit 2013. Ndërtimi i kësaj linje përfundoi në vitin 2016. Palët ranë dakord që fondet e papërdorura për kredinë e bankës KfW prej 42 milionë eurosh të përdoren për zgjerimin me 400 kilovoltë të nënstacionit të hidrocentralit të Komanit.

Për realizimin e projektit të zgjerimit të këtij HEC-i, ligji bazë u ndryshua me ligjin nr. 64 të vitit 2016, në datën 02.06.2016, i cili i shtyu afatet e disbursimit të huas nga 30 qershori i vitit 2013, në datën 30 dhjetor të vitit 2017.

Duke qenë se projekti i zgjerimit nuk ka përfunduar ende, palët ranë dakord për nënshkrimin e një marrëveshjeje të dytë ndryshuese, e cila synon shtyrjen e afateve të disbursimit të huas nga data 30 dhjetor i vitit 2017, në datën 30 dhjetor të vitit 2018.

Marrëveshja është me rëndësi të veçantë, sepse realizon projektin e zgjerimit të HEC-ve të Komanit dhe përmirësimin e cilësisë së rrjetit të transmetimit Tiranë-Prishtinë. Për këtë arsye i propozoj Komisionit të Ekonomisë ta miratojë atë.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime lidhur me këtë marrëveshje? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe bankës KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonjë, faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj dhe Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist i Drejtorisë së Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Vazhdojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Relatore e komisionit lidhur me këtë projektligj është zonja Evis Kushi.

Për të prezantuar projektligjin në komision kemi zëvendësministren e Financave dhe të Ekonomisë, zonjën Albana Shkurta.

Do ta nisim me prezantimin nga ana juaj, për të vazhduar më pas me relatoren.

Urdhëroni, zonja Shkurta!

Albana Shkurta – Përshëndetje!

Propozimi i këtij projektligji vjen si rrjedhojë e të qenit të Shqipërisë pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë, ku pjesë e angazhimeve të saj, si anëtare e OBT-së, që nga shtatori i vitit 2000, është që politika tregtare të ndjekë parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Të gjitha zhvillimet që ndodhin në OBT, gjithashtu, kërkojnë të përditësohen në mënyrë periodike, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kjo organizatë.

Një nga marrëveshjet e OBT-së, ku Shqipëria është palë që nga çasti i anëtarësimit, është edhe ajo e teknologjisë së informacionit, e cila bazohet në ligjin nr. 8648, datë 28.07.2000 “Për ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Marakeshit”, ku skeduli i koncesioneve dhe angazhimeve në mallra përcaktohet në pikën 2 të nenit 1 të këtij ligji. Sipas marrëveshjes së ITA-s për produktet që përdoren në teknologjinë e informacionit, vendet anëtare të kësaj marrëveshjeje nuk aplikojnë tarifa doganore në import.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje shtesë ka qenë për shkak të zgjerimit dhe rëndësisë që ka marrë teknologjia e informacionit në zhvillimet e fundit sot në botë. Procesi ka filluar që në vitin 2012, kohë në të cilën, me kërkesë nga Bashkimi Europian (një nga liderët e këtij procesi), Shqipëria iu bashkua iniciativës së BE-së, si pjesë e detyrimeve të Shqipërisë për përafrimin e politikës tregtare me politikën e përbashkët tregtare të BE-së, në zbatim edhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për t’iu bashkuar propozimit të BE-së, ministria përgjegjëse për tregtinë, ish-METE, ka zhvilluar në vijimësi konsultimet ndërmjet institucioneve shqiptare. Për këtë arsye Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ministria përgjegjëse për Inovacionin dhe Teknologjinë kanë dhënë dakordësinë e tyre për t’u bërë pjesë e kësaj liste gjatë kohës së diskutimit në OBT. Pas pranimin nga institucionet përgjegjëse, i është dhënë përgjigje pozitive kërkesës së Bashkimit Europian nëpërmjet misionit tonë në Gjenevë.

Projekti është në linjë me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ndryshimi i këtij ligji vjen si pasojë e ndryshimeve, sikundër thamë, të teknologjisë së informacionit vitet e fundit. Një ndër qëllimet kryesore të ndryshimit të këtij ligji është eliminimi i tarifave dhe produkteve të propozuara në këtë listë, si dhe eliminimi i barrierave jotarifore, që krijojnë pengesa të produktet e teknologjisë së informacionit.

Për ta çuar më tej objektivin e tregtisë, pa pengesa, në produktet e teknologjisë së informacionit, zgjerimi i ITA-s përfshin një rezultat të matur, por kuptimplotë në eliminimin e tarifave, përfitimet e të cilit do të jenë potencialisht të rëndësishme. Praktika në Organizatën Botërore të Tregtisë për vendet anëtare kërkon që secili vend, nëpërmjet parashikimeve të marrëveshjeve dhe të konventave të tjera ndërkombëtare, të pranojë angazhimet që dakordësohen në strukturat përkatëse të OBT-së.

Miratimi i skedulit të produkteve të ITA-s do të bëhet nëpërmjet instrumentit të pranimi, i cili është ndjekur edhe më parë në pranimin e marrëveshjes së lehtësimit të tregtisë. Procesi i miratimit të këtij projektakti ka filluar në nëntor të vitit 2016 dhe është përcjellë për miratim në Këshillin e Ministrave në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Ministria përgjegjëse për Financat kërkoi që propozimi i këtij projektligji të bëhej në kuadrin e paketës fiskale të vitit 2018 dhe projektakti u kthye për bashkërendim.

Pavarësisht kohës se kur do të propozohen ndryshimet e tarifave për produktet e kësaj liste, projektligji për pranimin e këtij skeduli duhet miratuar në formën e propozuar, sepse është pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe lista që miratohet nëpërmjet skedulit do të bëhet pjesë e skedulit të koncesioneve dhe angazhimeve në mallra të Shqipërisë në OBT. Shqipëria është i vetmi vend që nuk e ka përfunduar procedurën e miratimit të brendshëm, prandaj edhe miratimi i këtij projektligji është me prioritet.

Ky projektakt nuk synon përafrim me *acquis communautaire*. Teksti i përcaktuar në skedulin e aprovuar të listës përmban kodet tarifore të listuara sipas sistemit të harmonizuar të vitit 2007: përshkrimin e produkteve, tarifat bazë aktuale, reduktimin e tarifës dhe vitet për të cilat do të reduktohen tarifat.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si institucioni përgjegjës për zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e anëtarësimit në OBT, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë institucionet që ngarkohen për zbatimin e aktit.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Ministrinë për Europën dhe Punët me Jashtë. Sugjerimet e dhëna prej tyre janë reflektuar në këtë projektligj. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji që po shqyrtojmë propozohet nga Këshilli i Ministrave dhe vjen në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ai synon të realizojë angazhimet e ndërmarra nga vendi ynë, si vend anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë, i cili ka nënshkruar edhe marrëveshjen e teknologjisë dhe informacionit, me qëllim eliminimin e tarifave doganore për një kategori produktesh, si dhe eliminimin e barrierave jotarifore, që krijojnë pengesa të produktet e teknologjisë së informacionit.

Marrëveshja e teknologjisë dhe informacionit është një nga marrëveshjet e Organizatës Botërore të Tregtisë, e nënshkruar më 13 dhjetor të vitit 1996 nga 29 vende pjesëmarrëse në Konferencën Ministrore të Singaporit. Që atëherë numri i pjesëmarrësve është rritur në 82 vende, të cilat përbëjnë rreth 97% të tregtisë botërore në produktet e teknologjisë së informacionit.

Nxitur dhe e kushtëzuar nga zhvillimet që ka teknologjia e informacionit sot, mbi 50 vende anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë, në konferencën ministrore të Nairobit në dhjetor të vitit 2015, përfunduan zgjerimin e marrëveshjes, e cila tani mbulon një shtesë prej 201 produktesh me vlerë mbi 1,3 trilion dollarë në vit dhe që llogaritet të jetë rreth 7% e totalit të tregtisë globale sot.

Projektligji parashikon të tregtohen pa tarifë një listë e caktuar produktesh, duke filluar nga boja e printimit apo bojëra të tjera, ngjitës të përgatitur dhe adeziv të tjerë, pllaka dhe film fotografik, artikuj për mbajtjen apo paketimin e mallrave, kuti, kasa, arka dhe artikuj të ngjashëm, materiale të tjera të printuara, produkte dhe artikuj tekstilësh për përdorime teknike, pompa me ajër ose vakum, kompresor dhe ventilatorë me ajër ose me gaz dhe një listë e plotë produktesh.

Vendi ynë, në kuadër të detyrimeve për përafrimin e politikës tregtare me politikën e përbashkët tregtare të Bashkimit Europian, si dhe në zbatim edhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, iu bashkua kësaj iniciative duke dhënë dakordësinë nëpërmjet komisionit tonë në Gjenevë për t’u bërë pjesë e kësaj liste gjatë kohës së

diskutimit në Organizatën Botërore të Tregtisë. Miratimi i skedulit të produkteve të marrëveshjes për teknologjinë e informacionit do të bëhet nëpërmjet instrumentit të pranimi, i cili është ndjekur edhe më parë me pranimin e marrëveshjes së lehtësimit të tregtisë, miratuar me ligjin nr. 7 të vitit 2016. Efektet financiare të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2018 për këtë projektligj llogariten të jenë afërsisht 17 900 000 lekë.

Duke qenë se ndryshimet e propozuara do të sjellin reduktimin e kostos për të gjitha produktet nën mbulimin e marrëveshjes së informacionit dhe teknologjisë, si dhe meqë miratimi i projektligjit është prioritet, pasi vendi ynë është i vetmi vend që nuk e ka përfunduar procedurën e miratimit të brendshëm, u sugjeroj kolegëve ta mbështesim këtë projektligj dhe ta votojmë unanimisht. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi! Ka pyetje? Diskutime?

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Kush është kundër në parim?

Nuk ka.

Pro? Abstenim? Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Faleminderit, zonjë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj dhe Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Etleva Alushi – Specialiste e Drejtorisë së Projektit të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tedi Bushaj – Specialist i Drejtorisë së Borxhit Publik i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zoti Ilir Halilaj. Relator i komisionit për këtë projektligj është zoti Xhevit Bushaj. Viojmë me prezantimin tuaj dhe pastaj me relatorin.

Ilir Halilaj – Përshëndetje të gjithëve!

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit prej 23 milionë eurosh për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes.

Në marrëveshjen ekzistuese me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim kemi një kursim prej 4 milionë eurosh nga 31 milionë që ishte marrëveshja.

Sa i përket marrëveshjes së huas për shtesën prej 23 milionësh, ne mendojmë se do të mbështeten rreth 7 skema ujitëse, që do të rehabilitojnë ujitjen për rreth 16 500 hektarë. Kjo i shtohet rehabilitimit të rreth 24 mijë hektarëve në kuadër të marrëveshjes ekzistuese.

Janë rreth 7 skema ujitëse që do të mbështeten me anë të marrëveshjes:

1. Murriz-Thanë, degët Çukas dhe Lushnjë, pjesa e sipërme në bashkinë Lushnjë.
2. Tregtan 2 dhe 3 në bashkinë Has.
3. Sllanicë, në bashkinë Kuçovë.
4. Leminot, në bashkinë e Maliqit.
5. Sistemin e ujitjes me rezervuarët Janjar-Mursi me skemat Mursi-Xarrë, Konispol dhe Vagalat, në bashkinë Konispol.

Financimi përfshin edhe administrimin e kontratave të punimeve civile nëpërmjet shërbimeve të mbikëqyrjes, si dhe furnizimin e instalimin e instrumenteve të sigurisë për 14 diga të rezervuarëve ujitës në zonën e projektit, përfshirë trajnimin e stafit për përdorimin e

tyre.

Kjo ishte për sa i takon marrëveshjes së re.

Kjo marrëveshje është vazhdim i asaj ekzistuese, ku është përfshirë rehabilitimi i rreth 11 digave dhe vënia nën ujë e rreth 24 mijë hektarëve.

Erion Braçe – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Bushi!

Xhevit Bushi – Faleminderit, kryetar!

Projektligji vjen nga qeveria dhe është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe të ujitjes, me një hua në shumën 23 milionë eurosh, si dhe ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes.

Projektligji synon të rregullojë dy çështje: 1. Financimin e shtesës prej 23 milionë eurosh për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes. 2. Ndryshimin e huas së vitit 2013 për shkak të kësaj shtese financimi.

Marrëveshja fillestare është miratuar në vitin 2013 dhe me anë të saj synohet financimi i projektit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Bankës Botërore për burimet ujore dhe ujitjen, me qëllim përmirësimin e performancës së sistemeve të ujitjes në zonat që mbulon ky projekt. Projekti kishte një kosto prej 31 milionë eurosh.

Projekti i burimeve ujore dhe ujitjes përcakton kuadrin strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në planin kombëtar, konkretisht në basenet Drin – Bunë dhe Seman. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore është një prej objektivave që synon të përmbushë projekti. Objektivi tjetër lidhet me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të ujitjes në sistemet e përzgjedhura të ujitjes për këtë projekt.

Financimi shtesë prej 23 milionë eurosh, që sigurohet me anë të marrëveshjes së re të lidhur midis Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, do të mbështesë aktivitetet në komponentët:

1. Rehabilitimin e digave dhe sistemeve të ujitjes dhe kullimit me synim përmirësimin e performancës së organizatave që ofrojnë shërbimin e ujitjes;

2. Mbështetjen institucionale për ujitjen dhe kullimin me synim rehabilitimin dhe modernizimin e sistemit të ujitjes e kullimit dhe infrastrukturës së digave;

3. Mbështetjen për zbatimin e projektit me synim menaxhimin e burimeve të projektit në përputhje me objektivat dhe procedurat e tij.

Kjo hua shtesë e akorduar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ka termat e mëposhtëm:

- Shuma: 23 000 000 euro;
- Interesi: bazuar në normën e referencës + marzhin e pandryshueshëm;
- Tarifa front-end: 0,25% e shumës së kredisë;
- Komision angazhimi: 0,25% të përlllogaritur mbi vlerën e padisbursuar të huas;
- Maturimi: 25 vjet, përfshirë 7 vjet pa pagesë principali

Kategoritë e projektit që financohen me këtë shtesë prej 23 milionë eurosh janë:

1. Punime civile, mallra, shërbime konsulencë, trajnime, në shumën 22 942 500 euro;
2. Tarifa front-end në shumën 57 500 euro.

Qeveria shqiptare do të japë kontributin e saj për TVSH-në dhe koston lokale në shumën prej 4,6 milionë euro.

Ndryshimi i marrëveshjes ekzistuese të huas konsiston në tri elemente:

1. Ndryshime në tabelën e kostove, të cilat mundësojnë kalimin e kursimeve që rezultojnë nga disa aktivitete të përfunduara të projektit në zërin e investimeve, me qëllim rritjen e sipërfaqes ujitëse të rehabilituar.

2. Ndryshimi i objektivit të zhvillimit të projektit, me qëllim harmonizimin e tij me atë të financimit shtesë, në mënyrë që të dyja financimet, që do të realizohen në të njëjtën periudhë kohore, të kenë të njëjtin objektiv në përputhje me gjendjen dhe treguesit aktualë.

3. Ndryshimi që lidhet me rregullimin e emërimit të agjencisë zbatuese, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në përfundim, duke parë qëllimin, strategjinë, impaktin në zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe asaj të bujqësisë në veçanti, i ftoj kolegët deputetë ta miratojmë projektligjin.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Bushi!

Zoti zëvendësministër, unë kam disa pyetje për fazën e dytë, sepse ajo e digave është përfunduar dhe kolauduar, që ka të bëjë me skemat ujitëse që janë aplikuar, ndërtuar apo rindërtuar përmes kësaj.

Së pari, skema e Divjakës është me probleme edhe sot që flasim. Nuk e di nëse e keni marrë informacionin për këtë punë, por është një investim kolosal, që ka ngelur për gjëra, të cilat duhet të ishin parashikuar në projekt, por nuk janë parashikuar. Pra, projektuesi nuk ka bërë asgjë në këtë aspekt. Natyrisht, kjo rrezikon vënien në funksionim të skemës.

Njerëzit, sot që flasim, vijnë të vadin me puse, ndërkohë që i gjithë ky projekt u bë për të ezauruar pusët. Kjo ishte e para.

E dyta, ka të bëjë me cilësinë e punimeve në disa zona. Ngre shqetësimin që supervizori nuk i ka qëndruar punës në kokë. Pra, kontesti është drejtpërdrejt me supervizorin. Kjo nuk është thjesht dhe vetëm në skemën e Krutjes apo në atë të Divjakës, por bëhet fjalë edhe për skemën e ujitjes që është aplikuar në Fier, ku pasi ka rënë betoni, s'ka pasur asnjë rrjetë hekuri brenda tij.

E treta, unë e kuptoj dhe e lexoj shumë qartë edhe përfshirjen në projekt të sistemit ujitjes me rezervuarin e Janjarit, me skemat: Mursi, Xarë, Konispol- Valagat në bashkinë e Konispolit, por a jeni në dijeni, që sot që flasim, Tërbufi nuk vadit? Pra, bëhet fjalë për një sipërfaqe të konsiderueshme tokash, të cilat janë vaditur qëmoti me skemën që vinte nga Thana dhe sot nuk vaditen pothuajse fare. Pra, ku ndahet rruga te 3 Urat dhe deri në kufi me Shkumbinin, nuk vaditet më prej 15-20 vjetësh në mos më shumë.

Tokat më pjellore të Fushës së Myzeqesë për fat të keq, kultivojnë ose nuk kultivojnë një sezon dhe gjithmonë për ushqim për bagëtitë, se për produkte të tjera nuk bëhet fjalë për shkak se nuk ka ujë.

Shumë mirë që keni zbritur deri në Xarë, por të mbyllim një herë Myzeqenë, sepse nga kjo zonë kanë mbetur mijëra hektarë tokë, që nuk vaditen.

Ilir Halilaj – Faleminderit, i nderuar!

Financimi shtesë prej 23 milionësh të kërkuar me marrëveshjen e re, është në fakt një vazhdim i marrëveshjes ekzistuese. Aty ku është bërë ndërhyrja me marrëveshjen ekzistuese në digat dhe në rezervuarët, këto skema ujitëse janë në vazhdim të tyre.

Ndërkohë, në lidhje me shqetësimin për cilësinë dhe supervizionin e ndërhyrjeve ekzistuese, kjo është çështje që po trajtohet për të parë se ku mund të vlerësojmë impaktin negativ që mund të ketë pasur supervizioni apo cilësia e punimeve të ekzekutuara në rastin që përmendët.

Në lidhje me skemën e ujitjes së Divjakës, ne me shtyrjen e marrëveshjes ekzistuese për 3,6 milionë euro të kursyera në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të bëjmë të mundur futjen për herë të parë në ujitje të 4300 ha tokë bujqësore, kryesisht në zonën e bashkisë së Divjakës. 3000 ha në zonat Babunjë e Vjetër, Gur, Kamenicë, Rremas dhe një pjesë tjetër në zonën e Libofshës në bashkinë Fier (rreth 1300 ha).

Erion Braçe – Zoti zëvendësministër,

Nuk bëhet fjalë për këtë, por bëhet fjalë për skemën që është bërë, e cila pretendohet që ka përfunduar dhe për disa elementë të rëndësishëm, që lidhen drejtpërdrejt me barazhet dhe të tjera me radhë, skema mund të mos vihet në funksionim. Pra, të gjitha këto para shkojnë dëm, sepse as projektuesi nuk e ka pasur mendjen në punë, pavarësisht se është paguar shtrenjtë, edhe supervizori nuk e ka pasur mendjen në punë, pavarësisht se është paguar shtrenjtë.

Nuk po flas për kompaninë, që i ka lënë rrugët që ka çarë, të pambyllura. Nuk po flas për këtë pjesë. Ka çarë rrugët nacionale kompania dhe i ka lënë ashtu. Po them se skema nuk vihet në punë, nëse nuk ndërhyhet për të zgjidhur problematikën fundore që ka mbetur dhe që rrjedh drejtpërdrejt nga mënyra si është projektuar.

Ilir Halilaj – Desha të bëj një sqarim. Është ngritur një grup pune, ku është edhe kryetari i bashkisë dhe ditën e premte do të jetë në terren për të vlerësuar ndërhyrjen që është bërë në skemën ekzistuese.

Erion Braçe – Dakord, bëheni edhe këtë. Ishte vetë ministri dhe e pa me sytë e tij. Nëse përtej ministrit, duhen ngritur edhe grupe të tjera, i ngremë pa problem. Kemi kohë boll për muhabet, por problemi është se njerëzit duan të vadisin. Jemi në fund të majit dhe dje në Divjakë ishte temperatura 31 gradë dhe njerëzit duan ujë. Ky është problemi.

Ilir Halilaj – Besoj se do të kemi një vlerësim të saktë të të gjithë ndërhyrjes që është bërë në skemën ekzistuese ujitëse në atë zonë.

Erion Braçe – Kisha dhe një pyetje për Tërbufin, i cili sot që flasim, është jashtë skemës vaditëse, nuk ka fare ujë. Zero. Shyqyr që ra shi që vaditën përmes kullimit.

Ilir Halilaj – Në lidhje me skemën vaditëse, që prek Tërbufin, kjo do të mbetet të bëhet me ndërhyrjet tona dhe me buxhetin e ministrisë. Duhet të kemi një afat, sepse nga e gjithë Myzeqeja, mbetet pa vaditur vetëm Çërma.

Erion Braçe - Nuk janë pak, por janë mbi 4000 ha tokë që nuk vaditen. Është një potencial shumë i rëndësishëm ekonomik, që nuk shfrytëzohet sot dhe mbillet ose me jonxhë, ose me bar.

Ilir Halilaj – Do ta kemi parasysh ta fusim në kërkesat shtesë për projektbuxhetin.

Erion Braçe – Në qoftë se do të kurseni gjë nga shtesa që po bëjmë, pa asnjë diskutim do të bëhet. Të paktën, të mbeten në Myzeqe investimet.

Ka ndonjë shqetësim tjetër?

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të fjalës suaj, kam një shqetësim, të cilin e kam përcjellë edhe më parë për skemën e Kurjanit, e cila ka përfunduar. Sipas informacionit që kam, është marrë përkohësisht në dorëzim, por ajo çfarë dua të sjell në vëmendjen tuaj është se kjo lloj skeme përfshin 3 bashki: atë të Roskovecit, të Patosit dhe atë të Fierit. Cili do të jetë institucioni, i cili do ta menaxhojë këtë skemë? Rezervuari është faktikisht në administrim të bashkisë së Roskovecit dhe përfitues janë 3 bashkitë që përmenda.

Në lidhje me problemet atje, di që ka shkuar një grup pune, sepse ka shkarje në një zonë të njësisë administrative të Zharëzës. Mendohet që kjo skemë do të vihet në funksionim, por me këto probleme, në këtë situatë që është nuk mund të vihet në funksionim. Për këtë arsye do të doja një informacion nga ju.

Pyetja e dytë: A keni ndonjë projekt për vaditje mekanike për një pjesë të kësaj njësie administrative, e cila nuk përfshihet në skemën e Kurjanit? Është dorëzuar një projekt për vaditjen mekanike nga Lumi i Semanit dhe unë nuk e di nëse keni ndonjë informacion, që kjo skemë për vaditjen mekanike do të mbështetet nga ju, pasi është një sipërfaqe shumë e konsiderueshme, e cila punohet nga banorët e zonës dhe nuk përfshihet në vaditje nëpërmjet skemës së Kurjanit? Faleminderit!

Ilir Halilaj – Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket pyetjes për rezervuarin e Kurjanit, për ndërhyrjen që është bërë atje, është ngritur një grup pune për evidentimin e situatës që të bëhet vlerësimi i cilësisë së ndërhyrjes. Presim të informohemi për situatën.

Ndërkohë, në lidhje me kanalet që prekin 3 bashkitë: atë të Roskovecit, të Patosit dhe të Fierit, që kanë lidhje me rezervuarin e Kurjanit këto kanale janë në administrim të bashkive përkatëse. Ndërkohë, pritet që ndërhyrja e tyre në këto kanale të përmirësojë skemën e ujitjes në këto zona.

Nuk kemi parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2019 ndonjë projekt për vaditje mekanike nga Lumi i Semanit, për të rritur sipërfaqen e ujitjes në këto bashki.

Erion Braçe – Zoti Zëvendësministër,

Unë besoj se do ta kemi edhe në raportin e komisionit për në seancën plenare. Unë mendoj se të gjitha skemat që janë prekur nga huaja e parë apo nga marrëveshja e parë dhe kjo e dyta, nuk duhen marrë në dorëzim, nëse nuk bëhet prova me ngarkesë uji, sepse nga ajo që kam parë unë në terren dhe nga ajo që thonë bujqit, ka probleme të mëdha që rrjedhin nga projektimi. Nuk reflektohet ndryshimi që ka ndodhur në territor dhe kanalet janë mbi nivelin e tokës. Kështu pa diskutim, mos e merrni në dorëzim projektin as ju, as bashkitë, pa u bërë prova me ngarkesë, pra me ujë.

Në qoftë se uji nuk shkon te toka mos e merrni projektin në dorëzim, sepse pastaj do të hapen probleme të tjera të mëdha.

Mos e merrni projektin në dorëzim, nëse nuk korrigjohen të gjitha këto që thotë zonja Dhima, të cilat unë i kam parë me foto dhe disa të tjera që i kam parë vetë në territor, apo të tjerat, që lidhen drejtpërdrejt me projektimin dhe me supervizionin, pavarësisht se edhe bashkitë, edhe bujqit e kanë ngritur shqetësimin që në momentin e zbatimit. Mos bëni hapa përpara për të marrë në dorëzim projektin! Ky ishte shqetësimi im. këtë do ta them edhe në seancë plenare dhe do të përfshihet edhe në relacionin e komisionit, sepse nuk kemi ndërmend të bëhemi qepaze me njerëzit dhe me institucionet ligjzbatuese të vendit.

Praktikisht, duhet të ndërhyjnë dhe të bëjnë gjënë e duhur!

Ka ndonjë shqetësim tjetër?

Atëherë kalojmë në votimin e projektligjit!

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes””.

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Bushaj, të reflektohen të gjitha shqetësimet në relacionin e komisionit për në seancën plenare!

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA